TË DHËNAT TEKNIKE

ZEUS-AL

Bojra & Vernige

SMALTOLAC

BOJË ZMALTO PËR DRU & METAL



PËRSHKRIMI TEKNIK

SMALTOLAC është një produkt me bazë solventi i cilësisë së lartë, i përshtatshëm për aplikime dekorative të brendshme dhe të jashtme si dhe për aplikime mbrojtëse. Ofron mbrojtje të lartë të sipërfaqeve metalike ndaj kushteve atmosferike dhe rrezeve ultra violet. Gjithashtu, mund të përdoret për dekorimin dhe mbrojtjen e sipër-faqeve prej druri. Produkti është i disponueshëm në 24 ngjyra te gatshme. Gjithashtu gjendet të gjitha ngjyrat e katalogut RAL dhe në një sërë nuancash që mund të përgatiten me sistemin e ngjyrave **ZEUS-AL**.

CILËSITË

Aplikohet, nivelohet dhe ngjitet lehtë. Ka rezistencë të lartë ndaj goditjeve mekanike, kushteve të vështira atmosferike, pastrimit intensiv, gërvishtjeve dhe lagështisë. Ngjyra dhe niveli i shkëlqimit mbeten konstante pas një periudhe të gjatë kohore. Produkti ofron gjithashtu elasticitet të lartë dhe për këtë arsye mund t'i rezistojë punimit të drurit. Produkti mund të aplikohet shumë lehtë me furçë,rul ose pistoletë.

FUSHA E APLIKIMIT

Aplikohet për dekorimin e sipërfaqeve metalike dhe të sipërfaqeve prej druri si psh., kornizat e dritareve, pajisje druri dhe metalike, përdorime në ambiente industriale dhe detare psh., makineri, dyer metalike, anije, kangjella etj. Gjithashtu, përdoret te lodrat prej druri dhe objektet dekorative prej druri dhe metalike

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/i (Bojra specifike me nje komponent): 600g/l (2007) dhe 500g/l (2010).
Ky produkt përmban maksimalisht 470 g/l VOC.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

SMALTOLAC

BOJË ZMALTO
PËR DRU & METAL



APLIKIMI

Sipërfaqja që dëshirojmë të lyejmë duhet të jetë e pastër, e thatë, pa praninë e shtresave të vjetra të bojës, vajrave, yndyrnave, kripërave, etj.
Hollimi për furçë ose rul: 5-10% me BRUSH SOLVENT No 100, sipas peshës.
Hollimi për pistoletë: 5-15% me SPRAY SOLVENT No 200 , sipas peshës.
Aplikimi: Holloni dhe aplikoni 1-2 shtresa mbi sipërfaqen e pastruar më parë.
Për një performancë më të mirë mbrojtëse dhe anti korrozive sugjerohet që të aplikohet mbi një sipërfaqe tashmë të lyer me 1-2 duar me RUST PRIMER të **ZEUS-AL**.
Për sipërfaqet e aluminit ose të xinguara:
Aplikoni në fillim 1-2 shtresa me WASH PRIMER të **ZEUS-AL**.
Temperatura e aplikimit: 5 deri në 35°C.

TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: E bardhë & ngjyra.
Shkëlqimi, në 60°: 65±5 (ELOT EN ISO 2813-99)
Densiteti: 1.00–1.20±0.01 gr/ml në varësi të ngjyrës. **(**EN ISO 2811.01-02, 20°C)
Viskoziteti: DIN 6, në 25° C: 60-80 sec (ISO 2884.02-03)
Viskoziteti i aplikimit me pistoletë 4mm: 18-22 sec (ISO 2884.02-03)
Substanca të ngurta sipas peshës %: 65±2 (ELOT EN ISO 3251-03)
Koha e tharjes në 25°C:

- Tharja në sipërfaqe: 1-1½ orë
- Tharja në prekje: 3-4 orë
- Tharja në brëndësi: 24 orë
- Rilyerja: pas 16-24 orë

Pika e ndezjes: 26˚C (ELOT EN ISO 1523-02)
Ngjitja në metal (ndër-prerë): 0-1 (ELOT EN ISO 2409-95)
Ngjitja në WASH PRIMER (ndër-prerë): 0-1 (ELOT EN ISO 2409-95)
Fortësia (Könnig): 45 ±5 pas 7 ditësh (ELOT EN ISO 1522-00)
Elasticiteti (testi Mandrel): 3±1 mm passes (ELOT EN ISO 1519-02)
Mbulimi : 10-12 m²/lit për shtresë në sipërfaqet e përgatitura më parë dhe në varësi të ngjyrës.

PËR APLIKIMIN ME PISTOLETË
Përdoreni gjithmonë në një zonë të ajrosur mirë duke përdorur maska dhe dorashka për mbrojtje. Mos i thithni avujt.



ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com